



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 24.10.2017

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR TARIFAT GJYQËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 18.10.2017, 23.10.2017 dhe 24.10.2017 mori në shqyrtim projektligjin “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatorë për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Bashkim Fino.

Projektligji është paraqitur nga grupi i ekspertëve në Komisionin e Posaçëm, në mbledhjen e datës 16.12.2016, si pjesë e paketës së 27 projektligjeve të hartuara në kuadrin e reformës në drejtësi. Bazuar në vendimin 97/2016 të Kuvendit të Shqipërisë ky projektligj i ka kaluar për shqyrtim Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime ishin të pranishëm, eksperti i nivelit të lartë që ka draftuar projektligjin z. Genc Çifligu, përfaqësues të Misionit EURALIUS, zëvendësministri i Drejtësisë z. Toni Gogu dhe përfaqësues të kësaj ministrie, përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

I. Baza kushtetuese e projektligjit

Projektligji është propozim i një grupi deputetësh, bazuar në nenin 81 pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. Qëllimi dhe rrishtë e projektligjit.

Ky projekt-ligj ka si qëllim përcaktimin e tarifave për çështjet gjyqësore dhe shërbimet që ofrohen nga sistemi gjyqësor.

Në Dokumentin Analitik për Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri, sa i përket analizës së financimit dhe infrastrukturës të sistemit të drejtësisë, janë evidentuara problematikat e mëposhtme në lidhje me sistemin e tarifave gjyqësore:

- a) Ekzistenca e një situatë e paqartë ligjore në përcaktimin e tarifave gjyqësore.
- b) Mungesa e hierarkisë së tarifave të lidhura me shkallët gjyqësore dhe e një diferencimi tarifash midis llojeve të mosmarrëveshjeve.
- c) Mungesë totale e aplikimit të tarifave në Gjykatën Kushtetuese. Praktikisht të gjitha procedurat që kryhen para kësaj Gjykate janë pa pagesë. Nga aplikimi i këtij sistemi janë vërejtur probleme në drejtim të: i) shtimit të shpenzimeve administrative për shkak të rritjes së numrit të kërkesave gjatë viteve të fundit; i) shtimit të numrit të kërkesave të pabazuara dhe të përsëritura (me të njëjtat palë, objekt dhe shkaqe), gjë e cila ka çuar në abuzim me mjetet e ankimit.

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i sistemit të tarifave gjyqësore duke synuar vendosjen e tarifave të arsyeshme dhe proporcionale për shërbimet që ofron pushteti gjyqësor, në funksion të kategorizimit të tyre sipas llojeve të mosmarrëveshjeve dhe duke parashikuar përjashtime nga pagimi i tarifave gjyqësore, të cilat synojnë të rrisin aksesin në gjykatë të individëve që nuk kanë mundësi financiare. Qëllimi i këtij projektligji është në përputhje me listën e objektivave të vendosur në draft- strategjinë për sistemin gjyqësor “Mbështetje financiare dhe strukturore për sistemin e drejtësisë” dhe planin e veprimit për zbatimin e saj.

Projektligji është pjesë e një pakete ligjore që synon përmirësimin e aksesit në gjykatë për çështje të bazuara në ligj, uljen e mbingarkesës së gjykatave si dhe ofrimin e një shërbimi më të mirë për përdoruesit e gjykatës.

III. Grupi i punës i ngarkuar për hartimin e këtij projektligji dhe procesi i konsultimit të projektligjit.

Grupi i punës i ngarkuar për hartimin e këtij projektligji pjesë e shtyllës së financimit të drejtësisë është ngritur në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, dhe përbëhet nga ekspertë të nivelit të lartë vendas e ndërkombëtar të asistuar nga ekspertë të sekretariatit teknik, nën asistencën e misionit Euralius. Ky projektligj është diskutuar mbi bazën e një materiali fillestar të ardhur nga “Euralius”, duke u trajtuar dhe kthyer në një formë të re.

Gjatë fazës përgatitore të këtij projektligji, është bashkëpunuar ngushtësisht me: Zyrën e Administrimit të Buxhet Gjyqësor, Kryetarë Gjykatash, Ministrinë e Drejtësisë, Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Ekspertët e Sekretariatit Teknik, etj.

Në funksion të konsultimit publik, projektligji është përcjellë nga Komisioni i Ligjeve për konsultim pranë ministrive të linjës, institucioneve që preken nga fusha e zbatimit të tij, grupeve të interesit, organizatave të shoqërisë civile etj.

Në datën 16.02.2017 projektligji është diskutuar në tryezën e konsultimit të organizuar për këtë qëllim.

Është e rëndësishme të theksohet se nevoja për të përmirësuar draftin fillestar të depozituar në Kuvend, erdhi edhe për shkak të punës paralele për ndryshimin e një sërë ligjesh të tjera, pjesë të paketës së Reformës në Drejtësi, të cilat rregullojnë dispozita që ndërthuren mes tyre, si në rastin e Ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i

Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; projektligjit të ri “Për ndihmën juridike”.

Për të analizuar çdo koment të paraqitura për këtë projektligj nga institucionet që preken nga fusha e zbatimit të tij dhe shoqëria civile, u organizuan një sërë takimesh me ekspertë të nivelit të lartë që kanë hartuar draftin, përfaqësues të misionit EURALIUS, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, një kontribut të rëndësishëm në këtë grup ka dhënë edhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë z.Artan Lazaj. Grupi i punës diskutoi çdo sugjerim dhe koment të mbërritur me qëllim përmirësimin e draftit fillestar dhe përgatitjen e të draftit të konsoliduar i cili balacon të drejtën për akses në drejtësi me nevojën e reformimit të sistemit të tarifave gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

IV. Përmbledhje shpjeguese e ndryshimeve dhe shtesave të propozuara në projektligj.

Neni 1 i projektligjit rregullon objektin e këtij projektligji i cili është përcaktimi i llojeve të tarifave gjyqësore, masës, mënyrës, afatit të pagesës, si dhe rasteve të përjashtimit nga pagimi i tyre. Kategoritë e tarifave gjyqësore të parashikuara në këtë projektligj janë:

- a) Tarifa gjyqësore të përgjithshme, për paraqitjen e çështjeve në gjykata;
- b) Tarifa gjyqësore të veçanta, për kryerjen e veprimeve procedurale në gjykata dhe shërbimet e administratës gjyqësore; dhe
- c) Tarifa gjyqësore shtesë, në funksion të administrimit korrekt të procesit gjyqësor.

Në nenin 2 të këtij projektligji është parashikuar qëllimi i tij. Ky projektligji do të mbulojë tarifat gjyqësore në gjykimin e çështjeve civile, administrative, dhe në gjykimin në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim përfitimin e shërbimeve efektive dhe cilësore të ofruara nga gjykata. Me shfuqizimin e nenit 83 të ligjit të “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës kushtetuese” u krijua hapësira e nevojshme ligjore për vendosjen e tarifave për paraqitjen e kërkesave për shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 3 i projektligjit, jep përkufizimin e termave të përdorur në përmbajtjen e këtij projekti. Vlen për tu përmendur se përkufizimi i termit tarifë gjyqësore në krahasim me variantin fillestar të depozituar në Kuvend, është propozuar duke u mbështetur në konceptin e tarifës së përcaktuar në ligjin nr.9975/2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar parashikim i cili e koncepton tarifën si një pagesë për të shërbim të marrë, të mire publike të përdorur apo të drejte të dhënë. Konkretisht tarifa, përkufizohet si një pagesë që palët në proces kryejnë nëpërmjet administratës gjyqësore në favor të administratës tatimore qendrore.

Neni 4 trajton fushën e zbatimit të projektligjit duke parashikuar që tarifat gjyqësore të përcaktuara në këtë ligj zbatohen për të gjitha çështjet gjyqësore civile dhe administrative të paraqitura për shqyrtim në gjykatë dhe në të gjitha shkallët e gjykimit. Një çështje e diskutuar në grupin e punës ka qënë përfshirja në fushën e zbatimit të këtij projektligji të tarifave në çështjet gjyqësore në procesin penal. Në krahasim me variantin e parë të depozituar në Kuvend, projektligji i miratuar nga Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, nuk parashikon tarifë gjyqësore për procesin penal.

Kjo pasi, legjislacioni procedural penal nuk ka të parashikuar tarifa gjyqësore, por vetëm shpenzime procedurale që janë shpenzime të cilat bëhen për ekspertët që marrin pjesë në proces, të cilat nuk përfshihen në kuptimin e tarifave gjyqësore. Njëkohësisht ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale, parashikojnë të drejtën e viktimës së veprës penale (dëmtuarit akuzues) për tu përjashtuar, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhet me statusin e viktimës së veprës penale.

Neni 5 i projektligjit rregullon përcaktimin e tarifës gjyqësore të përgjithshme. Në krahasim me variantin fillestar të projektligjit të depozituar në Kuvendin e Shqipërisë, kjo dispozitë ligjore sipas variantit të miratuar nga Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Konkretisht nga skema e propozuar për caktimin e masave dhe llojeve të tarifave në përmbajtjen e projektligjit, projektligji i miratuar në komision parashikon që të bëjë kategorizimin e tarifave gjyqësore të përgjithshme për: paraqitjen e kërkesë-padisë, gjykimin në apel, gjykimin në gjykatën e lartë dhe gjykimin në Gjykatë Kushtetuese duke deleguar caktimin e masave të tyre me akt nënligjor të përbashkët të Ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe Ministrit përgjegjës për financat pas marrjes së propozimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ndërkohë projektligji ka parashikuar kufijtë minimale dhe maksimal brenda të cilave mund të caktohen vlerat e tarifave gjyqësore me akt nënligjor të këtyre institucioneve.

Gjatë shqyrtimit në komision, u diskutua çështja e përcaktimit të kufijve minimalë dhe maksimalë brenda të cilëve do të caktohet masave e tarifave gjyqësore të përgjithshme me akt nënligjor të dy ministrave me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga ana e relatorit dhe ekspertëve, u sqarua se nuk kemi rritje të tarifave. Kufiri minimal është caktuar në nivelin 1000 (njëmijë) lekë ndërkohë që aktualisht është në nivelin 3000 (tremijë) lekë. Kufiri maksimal është caktuar mbështetur në të dhënat e dërguara nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, për vlerat e tarifave gjyqësore të paguara gjatë tre viteve të fundit (2014, 2015, 2016) duke u bazuar në nivelin aktualisht në fuqi prej 1% të vlerës së objektit të padisë.

Nga ana e ekspertëve u sqarua se tarifat gjyqësore nuk do të paguheshin vetëm nga individit për çështje të natyrës civile ose të marrëdhënieve të punës, por ato do të paguheshin edhe shoqëritë tregtare për konflikte të ndryshme të natyrës tregtare, ku vlera e objektit të padisë është e shumë e lartë.

Dispozita ka parashikuar se masa e tarifave do të caktohet duke u bazuar në natyrën e çështjes, parimin e proporcionalitetit dhe progresivitetit.

Në këtë kuadër u vlerësua se masa konkrete e tarifave duhet të vazhdojë të jetë objekt rregullimi me akt nënligjor për arsyet e mëposhtme:

- a. Këshilli i Lartë Gjyqësor si institucioni i cili administron buxhetin e gjykatave, parashikohet të ketë në strukturën e tij Njësinë e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, e cila disponon informacionin në lidhje me të ardhurat e mbledhura nga tarifat gjyqësore për çështjet gjyqësore të depozituara dhe si e tillë mund të bëjë propozime të mirëstudiuara në lidhje me vlerën e tarifave gjyqësore.
- b. Nevoja për kryerjen e një studimi të plotë në caktimin e vlerave të tarifave nga institucioni përgjigjes për administrimin e sistemit të drejtësisë në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe progresivitetit. Ndërkohë miratimi i tyre parashikohet të bëhet me akt të përbashkët të ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat me qëllim që të sigurohet një balancë e drejtë ndërmjet nevojave të gjykatës për financim nga njëra anë dhe sigurimit të caktimit së niveleve të tilla të tarifave që sigurojnë të drejtën e aksesit të individëve në sistemin gjyqësor.

Tarifat e përgjithshme gjyqësore aplikohen para fillimit të çështjes dhe mbi këtë bazë nis gjykimi. Tarifa e përgjithshme gjyqësore është parashikuar të paguhet edhe për ankimet apo rekursin që paraqiten në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë.

Për sa i takon nevojës së përcaktimit të kufijve për tarifat gjyqësore të përgjithshme që do të paguheshin gjatë gjykimit në apel dhe Gjykatën e Lartë, gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision ekspertët sqaruan se ky parashikim është mbështetur në Analizën e Sistemit të Drejtësisë, sipas të cilës rezultoi se tarifa për t'iu drejtuar Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë aktualisht është mjaft e ulët (200 Lekë), dhe duhet të ndryshohet duke përfshirë një përqindje tjetër për çdo shkallë. Njëkohësisht ekspertët referuan edhe raportin e Komisionit Europian për Eficiencën në Drejtësi (CEPEJ) në të cilën argumentohet se sa më e lartë të jetë cilësia e drejtësisë që jepet aq më të mëdha janë edhe shpenzimet që paguheshin për përfitimin e

saj. Tarifat gjyqësore të përgjithshme për ankimin në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë janë përcaktuar në kujtë minimalë dhe maksimalë sa gjyma e kufijve të parashikuara për gjykimin në shkallën e parë. Ndërkohë që vlerat përkatëse të tarifave do të përcaktohet nga dy ministrat pas propozimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi bazën e parimeve të propocionalitetit, progresivitetit dhe analizave të mirëfillta që do të bëhen nga këto organe.

Neni 6 i projektligjit rregullon momentin e pagesës së tarifës gjyqësore të përgjithshme e cila si rregull duhet të paguhet në momentin e paraqitjes së padisë, të ankimit, ankimit të veçantë apo rekursit në gjykatë. Paragrafi i dytë i këtij neni parashikon rastin përjashtimor kur, nëse parashikohet me ligj procedural, tarifa e përgjithshme gjyqësore mund të paguhet gjatë gjykimit ose para dhënies së vendimit përfundimtar. Në krahasim me variantin e mëparshëm të projektligjit, përjashtimisht kjo pikë parashikon dy raste kur tarifa e përgjithshme gjyqësore mund të paguhet edhe në kohën e dhënies të vendimit si për shembull: për çështjet me objekt dhënien e pensionit ushqimor (kjo me qëllim mbrojtjen e interesave të të miturit); si dhe paditë me objekt marrëdhënie pune me vlerë deri në 700.000 lekë. Në dallim nga varianti i depozituar në Kuvend, në këtë nen është saktësuar se tarifa gjyqësore nuk kthehet në rast të heqjes dorë nga veprimet gjyqësore.

Neni 7 i projektligjit parashikon tarifat gjyqësore shtesë. Në dallim nga varianti i parë, kjo dispozitë është riformuluar duke u harmonizuar me parashikimet e bëra në ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Civile, (neni 107). Kjo dispozitë e cila i delegon ligjit të tarifave gjyqësore, përcaktimin e tarifave shtesë në rastin kur pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi i saj ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykimin e çështjes. Vendosja e këtyre tarifave ka si qëllim parandalimin e shtyrjeve të pa arsyeshme të seancave apo bllokimit të qëllimshëm të procesit.

Në harmoni me parashikimet e nenit 5 të projektligjit tarifa shtesë propozohet të përcaktohet në udhëzimin e përbashkët të Ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe Ministrit përgjegjës për financat me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në proporcion me tarifat gjyqësore të përgjithshme.

Neni 8 i projektligjit trajton tarifat gjyqësore të veçanta të cilat vendosen pasi çështja ka filluar dhe që lidhen kryesisht me kërkesat procedurale të cilat palët i paraqesin gjatë procesit të gjykimit dhe në të gjitha juridiksionet gjyqësore si dhe për shërbime të administratës gjyqësore. Dispozita për të harmonizuar skemën e caktimit të tarifave të veçanta me skemën e propozuar për tarifat e përgjithshme gjyqësore propozon nivele minimale dhe maksimale të tyre. Masa për llojet e tarifave gjyqësore të veçanta, parashikohet të përcaktohet me Udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe Ministrit përgjegjës për financat, me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas parimit të propocionalitetit dhe progresivitetit.

Si një përjashtim nga parimi i përgjithshëm, **neni 9 i projektligjit** parashikon rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifave gjyqësore. Në paragrafin e parë të këtij neni bëhet referim në legjislacionin e ndihmës juridike. Kjo pasi përjashtimi nga pagesa e tarifave gjyqësore është parashikuar si projektligjin përkatës si formë e ndihmës juridike. Arsyeja e përfshirjes së një parashikimi të tillë, është i lidhur me sigurimin e aksesit në drejtësi të individëve që përmbushin kriteret për përfitimin nga ndihma juridike.

Në çështjen (Kreuz kundër Polonisë) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut shprehet se: *“Edhe GJEDNJ-ja ka pohuar se neni 6 § 1 garanton të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës. Ajo ka konsideruar se sipas këtij neni, detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Gjykata ka rikujtuar edhe njëherë se ajo asnjëherë nuk e ka përjashtuar mundësinë që interesat e administrimit të drejtë të drejtësisë mund të justifikojnë një kufizim financiar në të drejtën e aksesit në gjykatë. Megjithatë, duke*

pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zë e drejta e aksesit në një shoqëri demokratike, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë aksesin në një mënyrë apo shkallë që dëmton thelbin e kësaj të drejte”.

Njëkohësisht Gjykata Kushtetuese në vendimin 7/2013 argumenton se: “*gjqytari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e kësaj tarife, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë. Gjyqtari i zakonshëm ka hapësirë për të vlerësuar plotësimin e këtij kriteri procedural për ngritjen e padisë dhe për të bërë përjashtimet rast pas rasti, në mënyrë që të mos pengojë realizimin e të drejtës së aksesit në gjykatë. Nëpërmjet interpretimit sistematik të dispozitave të mësipërme të KPC-së si dhe analogjisë me ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike” (përkatësisht nenet 2,10,13,14), arrihet qartësisht në përfundimin se qëllimi i këtij kuadri ligjor është të garantojë aksesin në gjykatë për të gjithë individët që i drejtohen gjykatës”.*

Nëpërmjet projektligjit të ri për ndihmën juridike, propozohet të rregullohen në mënyrë të detajuar, kategoritë që përjashtohen nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve të tjera gjyqësore. Konkretisht referuar projektligjit të ndihmës juridike kategoritë përfituese nga përjashtimi i pagimit të tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore janë subjektet që kanë pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme sipas parashikimeve të këtij ligji dhe subjektet që përfitojnë ndihmë juridike pavarësisht nivelit të të ardhurave dhe pasurisë së tyre si: viktimave të veprës penale; fëmijët të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesit shoqëror; viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e dhunës me bazë gjinore; personat që përfitojnë, nga statusi i të verbërit, si dhe të gjithë kategoritë e personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me parashikimet e ligjit për ndihmën dhe shërbimet shoqërore etj.

Po ashtu edhe institucionet e financuara nga buxheti i shtetit me funksione administrative, si dhe prokuroria dhe gjykatat përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore, përveç rasteve kur humbasin çështjen gjyqësore dhe ligji procedural parashikon detyrimin e tyre për paguar shpenzimet e palës tjetër, pasi aktiviteti i këtyre institucioneve është i lidhur ngushtë me institucionet gjyqësore dhe pagesa e tarifave gjyqësore do të sillte një mbingarkesë të panevojshme për buxhetin e shtetit dhe burokraci të panevojshme.

Në bazë të propozimit të paraqitur nga Avokatura e Shtetit në përmbajtjen e këtij neni është shtuar një paragraf në të cilin parashikohet përjashtimi i këtij institucioni nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore.

Neni 10 i këtij projektligji parashikon që mënyra e mbledhjes dhe pagesës së saj do të rregullohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe Ministrit përgjegjës për financat pas marrjes së mendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një tjetër risi që sjell ky variant i ripunuar i projektligjit të tarifave dhe që vjen si zgjidhje e problematikës së financimit të pamjaftueshëm të gjyqësorit, problematikë e trajtuar gjerësisht kjo në Dokumentin analitik, është kalimi të buxhetit gjyqësor i 10% të shumës së përgjithshme të arkëtuar të tarifave gjyqësore. Një parashikim i tillë besohet se do të kontribuojë drejtpërdrejtë në pavarësinë financiare të gjyqësorit dhe në përmirësimin e infrastrukturës së tij.

Neni 11 i projektligjit, është një dispozitë e re në krahasim me variantin e depozituar në Kuvend. Kjo dispozitë vjen si adresim i komenteve të paraqitura nga Ministria e Financave në lidhje me rregullimin e çështjes së deklarimit të tarifave për sa kohë që tarifat gjyqësore nuk do të jenë më objekt trajtimi në ligjin e taksave kombëtare duke bërë të nevojshme rregullimin në dispozitat e këtij projektligji të deklarimit dhe transferimit të të ardhurave të arkëtuara nga tarifatat pranë administratës tatimore.

Neni 12 i projektligjit parashikon që tarifa gjyqësore si çdo e ardhur në buxhetin e shtetit t'i nënshtrohen procesit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nenet 13 dhe 14 të projektligjit parashikojnë rregullimin tranzitor të përlogaritjes dhe zbatimit të tarifave gjyqësore deri në momentin e nxjerrjes së akteve nënligjore të parashikuara në përmbajtjen e këtij projektligji.

Gjithashtu në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës projektligji përcakton nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij dhe afatin e miratimit të tyre, i cili parashikohet të jetë i lidhur me ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 15, parashikon hyrjen në fuqi të këtij projektligji. Gjatë shqyrtimit të projektligjit, Komisioni diskutoi hyrjen në fuqi të tij. Duke qënë se projektligji i tarifave gjyqësore dhe projektligji i ndihmës juridike, janë dy projekt-akte të lidhura ngushtësisht me njëra- tjetrën, Komisioni vendosi që afati i hyrjes në fuqi të jetë data 1 Qershor 2018. Njëkohësisht për ti dhënë mundësi organeve përgjegjëse për nxjerrjen e akteve nënligjore, për të miratuar këto akte përpara datës 1.6.2018 nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor konstituohet përpara kësaj date u parashikua që hyrja në fuqi e nenit 14 të bëhet 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

- Përfundime

Në përfundim, Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, gjatë shqyrtimit nen për nen dhe sipas propozimeve, miratuan ndryshimet, sipas variantit integral, bashkëlidhur këtij raporti.

RELATOR

KRYETAR

BASHKIM FINO

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/____2017

**“PËR
TARIFAT GJYQËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI :

Neni 1

Objekti

1. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e llojeve të tarifave gjyqësore, masën, mënyrën dhe afatin e pagesës, dhe rastet e përjashtimit nga pagimi i tyre.

2. Tarifat gjyqësore sipas këtij ligji janë:

- a) Tarifa gjyqësore të përgjithshme, për paraqitjen e çështjeve në gjykata;
- b) Tarifa gjyqësore të veçanta, për kryerjen e veprimeve procedurale në gjykata dhe shërbimet e administratës gjyqësore; dhe
- c) Tarifa gjyqësore shtesë, në funksion të administrimit korrekt të procesit gjyqësor.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i tarifave gjyqësore në gjykimin e çështjeve civile, administrative, dhe në gjykimin në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim përfitimin e shërbimeve efektive dhe cilësore të ofruara nga gjykata.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Tarifë gjyqësore” është një pagesë që palët në proces kryejnë nëpërmjet administratës gjyqësore në favor të administratës tatimore qendrore;
2. “Palë në proces” është personi fizik ose juridik ose përfaqësuesi i tij ligjor që ka vënë në lëvizje gjykatën me qëllim zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në rrugë gjyqësore.
3. “Gjykata” sipas kuptimit të dhënë nga ky ligj janë gjykatat e sistemit gjyqësor dhe Gjykata Kushtetuese.

Neni 4 **Fusha e zbatimit**

1. Tarifat gjyqësore të përcaktuara në këtë ligj zbatohen për të gjitha çështjet gjyqësore civile dhe administrative të paraqitura për shqyrtim në gjykatë dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.
2. Tarifat gjyqësore zbatohen edhe për përfitimin e shërbimeve të ofruara nga gjykata.

Neni 5 **Përcaktimi i tarifës gjyqësore të përgjithshme**

1. Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesëpadisë përllogaritet mbi bazën e vlerës së padisë për çështje gjyqësore civile dhe administrative.
2. Masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme sipas pikës 1 të këtij neni, është jo më e ulët se 1000 (njëmijë) lekë dhe jo më e lartë se 20.000.000 (njëzet milion) lekë.
3. Masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme për gjykimet në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë është jo më e ulët se 2000 (dy mijë) lekë dhe jo më e lartë se 10.000.000 (dhjetë milion) lekë.
4. Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese është 5.000 (pesëmijë) lekë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 9 të këtij ligji.
5. Përcaktimi i vlerës së padisë bëhet nga personi, i cili ka ngritur padinë përpara gjykatës.
6. Në rast se përllogaritja e vlerës së padisë mungon ose nuk është llogaritur në mënyrë të saktë, veprohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.
7. Kur çështja gjyqësore kthehet për rigjykim nga gjykatat më të larta, nuk paguhet tarifë gjyqësore e përgjithshme.
8. Llojet dhe masat përkatëse të tarifave gjyqësore të përgjithshme sipas këtij neni, për çdo shkallë gjykimi përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe Ministrit përgjegjës për financat me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi bazën e natyrës së çështjes, parimeve të proporcionalitetit dhe progresivitetit.

Neni 6 **Momenti i pagimit i tarifës gjyqësore të përgjithshme**

1. Tarifa gjyqësore e përgjithshme paguhet në momentin e paraqitjes së padisë, të ankimit, të ankimit të veçantë ose të rekursit në gjykatë, përveçse kur ligji parashikon ndryshe.
2. Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesave në Gjykatë Kushtetuese paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës pranë kësaj gjykate.

3. Nëse tarifa gjyqësore e përgjithshme nuk është paguar në momentin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, gjykata vepron në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.
4. Tarifa gjyqësore e përgjithshme paguhet gjatë gjykimit ose përpara dhënies së vendimit përfundimtar vetëm në rastet e mëposhtme:
 - a) kur çështja gjyqësore ka për objekt dhënien e pensionit ushqimor;
 - b) për paditë për marrëdhëniet e punës në vlerë deri në 700.000 (shtatëqindmijë) lekë.
5. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore.

Neni 7 **Tarifa gjyqësore shtesë**

1. Tarifa gjyqësore shtesë caktohet në rastet kur pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi i saj ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykim e çështjes.
2. Tarifa gjyqësore shtesë paguhet brenda 21 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës.
3. Tarifa gjyqësore shtesë është tarifë fikse dhe përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe Ministrit përgjegjës për financat me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në proporcion me tarifën gjyqësore të përgjithshme sipas nenit 5 të këtij ligji.

Neni 8 **Tarifa gjyqësore e veçantë**

1. Tarifa gjyqësore e veçantë caktohet për shqyrtimin e kërkesave të veçanta procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në të gjitha juridiksionet gjyqësore si dhe për shërbime të administratës gjyqësore.
2. Tarifa gjyqësore e veçantë paguhet në kohën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë.
3. Tarifat gjyqësore të veçanta janë jo më e ulta se 50 (pesëdhjetë) lekë dhe jo më të larta se 2500 (dymjë e pesëqind) lekë. Masa për llojet e tarifave gjyqësore të veçanta, përcaktohet me Udhëzim të përbashkët të Ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe Ministrit përgjegjës për financat, me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas parimeve të proporcionalitetit dhe progresivitetit.

Neni 9 **Përfjashtime nga pagesa e tarifës gjyqësore**

1. Palët ndërgjyqëse mund të përfjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore kur është bërë kërkesë prej tyre, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmë juridike.
2. Çdo organ publik buxhetor që kryen funksione administrative, gjykatat ose prokuroria, përfjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore, përveç rasteve kur humbasin çështjen gjyqësore dhe ligji procedural parashikon detyrimin e tyre për paguar shpenzimet e palës tjetër.

3. Rregulli i parashikuar në pikën 2 të këtij neni nuk zbatohet për Avokaturën e Shtetit, e cila përjashtohet edhe nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore.

Neni 10

Mënyra e pagimit të tarifës gjyqësore

1. Tarifa gjyqësore mblidhet dhe paguhet sipas mënyrës së përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat pas marrjes së mendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Nga shuma e përgjithshme e arkëtuar për tarifën gjyqësore 10 (dhjetë) përqind i kalon buxhetit gjyqësor.
3. Mbi tarifatat gjyqësore të parashikuara në këtë ligj nuk aplikohet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar.

Neni 11

Deklarimi i tarifave

1. Administrata e gjykatave, në cilësinë e agjentëve të mbledhjes së tarifave, të parashikuara në këtë ligj detyrohen:

- a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;
- b) të paguajnë për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën e arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës;

2. Deklarata, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të ministrit të Financave. Deklarata për pagesën e tarifës gjyqësore plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga administrata e gjyqësore. Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. Administratat Gjyqësore duhet të dorëzojnë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifatat.

3. Në rast shkelje të parashikimeve të këtij nenin ndaj administratës gjyqësore zbatohen sanksionet e parashikuara nga neni 117 i ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 12

Auditimi i tarifave gjyqësore

1. Përlllogaritja dhe arkëtimi i tarifave gjyqësore verifikohet dhe vlerësohet sipas legjislacionit në fuqi për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm në sektorin publik.

2. Kur vlera dhe procedura e caktimit të tarifës është ankimuar në gjykatat më të larta, vendimi gjyqësor përkatës mbahet në konsideratë në procedurën e auditimit të brendshëm apo të jashtëm.

Neni 13
Dispozitë kalimtare

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha çështjet gjyqësore që paraqiten në gjykata pas hyrjes në fuqi të tij.
2. Deri në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara nga ky ligj tarifat gjyqësore do të përlllogariten dhe zbatohen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për taksat kombëtare dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 14
Akte nënligjore

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave që brenda 3 muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojnë aktet nënligjore të parashikuar në pikën 8 të nenit 5, në pikën 3 të nenit 7, në pikën 3 të nenin 8 dhe në pikën 1 të nenit 10 të këtij ligji.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datë 01 Qershor 2018.
Përfundimisht neni 14 i këtij ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI